URDHËR
Nr.49, datë 19.4.2011

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË MARRËVESHJES PËR KRYERJEN E OPONENCËS TEKNIKE PËR PROJEKTET E VEPRAVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të ligjit nr.8402, datë 18.7.2002 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, si dhe pikës 2, 4 të vendimit nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit",

URDHËROJ:

1. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit për:

a) objekte banimi, social-kulturore e industriale;

b) objekte hidroteknike e portuale (diga, tunele, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje, thellime në det);

c) objekte të infrastrukturës së transportit (rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale).

2. Subjektet e mësipërme para kryerjes së oponencës teknike, lidhin një marrëveshje me porositësin, sipas marrëveshjes tip bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Pagesa për oponencën teknike të projekteve të bëhet sipas pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit".

4. Urdhri nr.187, datë 20.6.2004 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme të aktmarrëveshjes dhe objektit të oponencave teknike të projekteve të ndërtimit, si dhe caktimi i institucioneve shtetërore për kryerjen e tyre shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MARRËVESHJE TIP

E mbajtur sot në Tiranë datë _____, midis:

Porositësi:

_____

Sipërmarrësi:

_____

Të cilët, me qëllim krijimin e marrëdhënies juridike, bazuar në kreun VII, neni 850 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë", të

ndryshuar, lidhin këtë marrëveshje me përmbajtje që vijon:

Objekti i marrëveshjes: _____

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në momentin kur porositësi vë në dispozicion të sipërmarrësit të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij.

2. Sipërmarrësi në rast se nuk realizon oponencën brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të kësaj marrëveshje, i paguan porositësit 0.01% (për qind) të vlerës totale të projektit, për çdo ditë vonese.

3. Vlefta: Vlefta për realizimin e objektit sipas kësaj marrëveshje është _____ lekë, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit".

4. Afati: Dorëzimi i oponencës teknike pranë sipërmarrësit do të jetë _____ ditë/muaj nga data e lidhjes së kësaj marrëveshjeje.

5. Në rast se gjatë realizimit të objektit lindin mosmarrëveshje, palët i zgjidhin ato me mirëkuptim midis tyre, në rast të kundërt i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë për zgjidhje.

6. Pagesa e vleftës për realizimin e oponencës kryhet në momentin e dorëzimit të saj te sipërmarrësi në nr. e llogarisë _____ dhe IBAN _____.

Klienti brenda afatit dhe kushteve të marrëveshjes, duhet të realizojë oponencën teknike për projektin e veprës së ndërtimit_____.

7. Kjo marrëveshje hartohet në 3 kopje origjinale, me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve.

Porositësi	Sipërmarrësi
Znj./Z._____	Znj./Z._____

Shënim. *Sipërmarrësi do të jetë njëri nga subjektet e përcaktuara në urdhrin bashkëlidhur.